



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Datë: 19.02.2025
Numër Protokolli: 1313/2025

A.nr.54/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, si dhe Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.54/2025, të datës 10.01.2025, të parashtruar nga ankuesi A.M, kundër organit të punësimit/Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike “*shkelje e të drejtës në pagë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 19.02.2025, mori këtë:

V E N D I M

I.Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.54/2025, e datës 10.01.2025, e parashtruar nga ankuesi A.M, ashtu që, **aprovohet** pretendimi i ankuesit referuar shkelje ligjore në nxjerrje të vendimit të kundërshtuar më ankesë, ndërsa, **refuzohet** pretendimi ankimor për kompensimin në mënyrë retroaktive të diferencës së koeficientit të pagës nga 6 në koeficient 8.64 dhe kompensimin e 0.5% të përvojës së punës.

II.Anulohet Vendimi me Nr.14-400/04-158061/24, i datës 10.12.2024, i ud. Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil A.M (*tutje referuar vetëm ankuesi*), më datë 10.01.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.14-400/04-158061/24, të datës 10.12.2024, të ud. Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, për shkak të shkeljeve të Ligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative dhe Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetues të datës 23.01.2024.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 15.01.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e 7ankueses tek Komuna e Prishtinës, ndërsa kjo e fundit më datë 27.01.2025 ka dërguar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokollit 92/2025 të datës 10.01.2025 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e datës 29.11.2024 e parashtruar nga ankuesi për Kryetarin e Komunës dhe Udhëheqësin e Sektorit të Burimeve Njerëzore; Vendimin me Nr. 14-400/04-158061/24 të datës 10.12.2024, të ud. Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës; Akt Emërimit 01nr.112-033 të datës 01.02.2019; Kopjen e ID-së së ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 15.01.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 27.01.2025; Listën e pagave nga Thesari i Kosovës për ankuesin janar-dhjetor 2024; Kartelën e nëpunësit dhjetor 2022 dhe janar e shkurt 2023; Kërkesën për ri sistemim e datës 24.01.2019; Vendimin me Nr. 14-117/01-0018330/19 i datës 30.01.2019; Listën e pagave dhjetor 2022, janar, shkurt 2023, shkurt -dhjetor 2024 dhe janar 2025; Vendimi 14-112/02-74990/22 i datës 05.04.2022 i Kryetarit të Komunës së Prishtinës, Vendimi 14-112/13-155969/22 i datës 05.07.2022 i Kryetarit të Komunës së Prishtinës, Vendimi 14-112/02-74990/22 i datës 05.04.2022 i Kryetarit të Komunës së Prishtinës, Vendimi 14-112/02-207283/22 i datës 30.09.2022 i Kryetarit të Komunës së Prishtinës, Vendimi 14-112/02-276598/22 i datës 28.12.2022 i Kryetarit të Komunës së Prishtinës, Vendimi 14-112/02-68297/23 i datës 31.03.2023 i Kryetarit të Komunës së Prishtinës, Vendimi 14-112/02-13955/23 i datës 05.07.2023 i Kryetarit të Komunës së Prishtinës, Vendimi 14-112/02-0201950/23 i datës 04.10.2023 i Kryetarit të Komunës së Prishtinës, Vendimi 14-112/02-43522/24 i datës 39.03.2024 i Kryetarit të Komunës së Prishtinës dhe Vendimi 14-112/02-0133832/24 i datës 11.10.2024 i Kryetarit të Komunës së Prishtinës.

Duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankesa e ankuesit ***është pjesërisht e bazuar, sepse:***

Nga administrimi i shkresave të lëndës del se ankuesi sipas Akt Emërimit 01 nr.112-93,3 të datës 01.02.2019, mban pozitën e punës *Auditor i Brendshëm*, në Komunën e Prishtinës.

Tutje, nga provat e çështjes rrjedhë së ankuesi më datë 29.11.2024, ka parashtruar kërkesë tek Kryetari i Komunës dhe Udhëheqësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës për aprovimin e pagës sipas Aktgjykimit në rastin KO79/2023 të datës 24.01.2024 të Gjykatës Kushtetues, ashtu që i njëjtit ti njihet kompensimi i pagës së fituar para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik dhe kompensimi i përvojës së punës prej 0.5% për çdo vit të përvojës së punës.

U.d Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës, me Vendimin Nr.14-400/04-158061/24, të datës 10.12.2024, ka refuzuar kërkesën e datës 29.11.2024 të ankuesit me arsyetimin se paga e nëpunësit civil realizohet sipas nenit 13 të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa kompensimi i përvojës së punës realizohet sipas nenit 44 dhe 47 të këtij ligji.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton ligjshmërinë e Vendimit Nr. 14-400/04-158061/24 të datës 10.12.2024, të ud. Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, me pretendimet se i njëjti është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenin 35 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, sepse pozita e Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore është mbajtur më shumë se 12 muaj me ushtrues detyre. Me tej, thekson se kërkesa e ankuesit mbi bazën si në ankesë nuk është trajtuar ne pajtim me Aktgjykimin AGJ 2314/24 të datës 23.01.2024, të Gjykatash Kushtetues, sepse sipas këtij aktgjykimi, paga e fituar e auditorit të brendshëm ka qenë me koeficient 15, ndërsa, me Ligjin Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin publike është paraparë koeficienti 6. Kërkon që të aprovohet ankesa, të anulohet akti administrativ dhe të obligohet

Komuna e Prishtinës që të bëjë kompensimin nga koeficienti 6 në atë 8.64 si dhe 0.5% të përvojës së punës në mënyrë retroaktive dhe të njëjtin ta sistemoj me koeficient 8.64.

Kolegji i Këshillit, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit referuar ligjshmërisë së vendimit të kundërshtuar më ankesë, ka analizuar provat materiale të kësaj çështje administrative, nga ka konstatuar se ky pretendim ankimor ka mbështetje ligjore për faktin se pozita e menaxherit të personelit në Komunën e Prishtinës është pozitë e lirë që nga viti 2022, rrejdhimisht z. F.A, që nga muaji prill 2022 ka qenë u.d menaxherit të personelit në Komunën e Prishtinës, mirëpo, Kolegji ligjshmërinë e emërimit të z. F.A si u.d të menaxherit të personelit e trajtoj vetëm në kuptim të dispozitave të ligjit në fuqi për zyrtaret publikë, me konkret sipas dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197, në fuqi nga data 25.11.2023. Andaj, mbi këtë bazë, Kolegji duke ju referuar provave materiale konstaton se sipas Vendimit 14-112/02-0201950/23 të datës 04.10.2023, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, z. F.A është caktuar ushtrues detyre i menaxherit të Personelit nga data 12.10.2023 deri më 11.04.2024, sipas Vendimit 14-112/02-43522/24, të datës 39.03.2024, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, z. F.A është caktuar ushtrues detyre i Menaxherit të Personelit nga data 12.04.2024 deri me 11.10.2024, dhe sipas Vendimi 14-112/02-0133832/24 i datës 11.10.2024, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, z. F.A është caktuar ushtrues detyre i Menaxherit të Personelit nga data 12.10.2024 deri me 11.04.2025. Pra, mbi gjendjen e këtyre rrjedhë së z. F.A ka mundur të ushtroj pozitën e ud. Menaxherit të Personelit të Komunës së Prishtinës vetëm deri me datë 25.11.2024, dhe së çdo vendim i ndërmarr pas kësaj datë nga z. F.A konsiderohet veprim i paligjshëm ashtu siç përcaktohet me nenin 35 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *“1. Në rast se një pozitë e nivelit drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësja/i i nivelit të lartë drejtues e atij institucioni e cakton me vendim ushtruesen/in e detyrës për pozitën e lirë. 2. Në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, ushtruesja/i i detyrës mund të caktohet zyrtarja/imë i lartë i kategorisë pasuese, në vartësi të pozitës që caktohet, nga cilado njësi organizative brenda institucionit. 3. Zyrtarja/i publik nuk mund të caktohet si ushtrues/e/i detyre më gjatë se gjashtë (6) muaj. Kur pozita nuk mund të plotësohet brenda afatit gjashtë (6) muaj, ky afat mund të zgjas më së shumti edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë. 4. Pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se afati i përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni. 5. Çdo vendim i marrë nga ushtruesja/i i detyrës, pas kalimit të afatit të përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni, është i paligjshëm”*.

Rrjedhimisht, referuar përcaktimeve ligjore sipas nenit 35 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, çdo veprim i ndërmarr nga z. F.A pas datës 25.11.2024, konsiderohet veprim i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.5 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që, edhe vendimi i kontestuar i nxjerr më datë 10.12.2024 nga z. F.A është vendim i paligjshëm, andaj, Këshilli të njëjtin e anuloi në pajtim me autorizimet sipas nenit 53 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, mirëpo, nuk detyroj Zyrtarin Kryesor Administrativ lidhur me plotësimin e pozitës së menaxherit të personelit, pasi që tashme procedura e pranimit lidhur me këtë pozite ka përfunduar sipas konkursit me numër të referencës RN0008698.

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve për kompensimin e koeficientit të pagës dhe 0.5% të përvojës së punës, Kolegji iu referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, në fuqi nga data 05.02.2023, me theks të veçantë:

- **Nenit 1:** *1. Qëllimi i këtij ligji është që të krijojë një sistem të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik që përfshin parimet dhe rregullat për përcaktim të pagës në sektorin publik si dhe të krijojë një sistem të pagave dhe shpërblimeve, transparent dhe të menaxhueshëm ku elementi kryesor është paga bazë.*

- **Nenit 2** paragrafi 1 dhe 3: *1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, përjashtimisht Agjencisë Kosovare për Inteligjencë. 3. Për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të*

Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, ky ligj zbatohet për atë që nuk cenon pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative të garantuar me Kushtetutë”.

-Nenit 6, paragrafi 1 dhe 6: *1.Paga bazë është pjesa fikse e pagës që përfitohet për punën e kryer me orar të plotë apo punën me orar të pjesshëm që konsiderohet si punë me orar të plotë, në një funksion apo pozitë të caktuar që përcaktohet nga grupi dhe klasa e pagës së cilës i përket funksioni apo pozita, ashtu siç është përcaktuar në shtojcat e këtij ligji. 6. Paga bazë rritet në bazë të përvojës së punës, në masën: 6.1. zero pikë njëzetë e pesë për qind (0.25%) për çdo vit të plotë pune, deri në pesëmbëdhjetë vite (15) punë; dhe 6.2. zero pikë pesë për qind (0.5%) për çdo vit të plotë pune, mbi pesëmbëdhjetë vite (15) punë*

Nenit 41: *1.Nëse një zyrtar/e publik/e apo funksionar/e publik/e, para hyrjes në fuqi të këtij ligji përfitonte pagë që është më e madhe se paga e plotë e parashikuar me këtë ligj, ajo/ai do të përfitojë pagën e re sipas dispozitave të këtij ligji dhe shtesën tranzitore të barabartë me diferencën ndërmjet pagës aktuale dhe pagës së re bazë.2. Të punësuarat/it, zyrtarja/i publik/e apo funksionarja/i publik/e, në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, do të përfitojë pagën e re në: 2.1. 100% të shtesës tranzitore të posaçme, sipas paragrafit 1, gjatë vitit të parë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji; 2.2. 50 % të shtesës tranzitore të posaçme, sipas paragrafit 1, gjatë vitit të dytë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. 3. Përfshirë nga paragrafi 1. dhe 2. i këtij neni, anëtarët/ët e shërbimit të jashtëm nuk gëzojnë të drejtën e shtesës tranzitore. 4. Çdo person që punësohet pas miratimit të këtij ligji përfiton pagën sipas këtij ligji dhe nuk gëzon të drejtën e shtesës tranzitore.*

Neni 45 paragrafi 2: *2. Me hyrje në fuqi të këtij ligji shfuqizohet gjithashtu çdo dispozitë e ligjit apo e aktit nënligjor tjetër që rregullon çështjen e pagës, kompensimeve, shtesave, shpërblimeve apo kategorie tjetër në fushën e pagave, e që nuk është autorizuar shprehimisht për t'u nxjerr nga dispozitat e këtij ligji.*

Po ashtu, Kolegji për vendosje të drejt dhe meritore mori parasysh edhe përcaktimet e Gjykatës Kushtetuese sipas Aktgjykimit për rastin nr.KO79/23, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, (në fuqi më datë 01.02.2024), e më të cilin aktgjykim janë shpall të pavlefshëm paragrafi 6 i nenit 6, paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41, dhe paragrafi 2 i nenit 45, me efekt veprimi nga dita e hyrjes në fuqi të këtij aktgjykimi. Ndërsa, ka detyruar Kuvendin e Republikës së Kosovës që brenda gjashtë muajsh nga hyrja në fuqi e këtij aktgjykimi të ndryshojë dhe plotësoj paragrafin 2 të nenit 2 dhe paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë.

Rrjedhimisht Gjykata Kushtetuese me Aktgjykimin në rastin Nr.KO79/23, ka sqaruar: Pika 323.Në kontekst të përcaktimit të “ndërhyrjes/kufizimit” të së drejtës në gëzimin paqësor të pronës të funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve publikë përmes Ligjit të kontestuar, sipas në kontekst të sqarimeve të mësipërme, Gjykata thekson që nuk është kontestuese që një pjesë të konsiderueshme të funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve që bien në fushëveprimin e Ligjit të kontestuar, iu është zvogëluar paga, përderisa një pjesë tjetër iu është ngritur paga. Për më tepër, Gjykata thekson që neni 45 i Ligjit të kontestuar shfuqizon dispozitat e të gjitha ligjeve të veçanta dhe të cilat kanë përcaktuar nivele/raporte të pagave dhe/ose të drejta të caktuara të funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve të shtetit, përfshirë të drejtën e gjyqtarëve dhe prokurorëve për ruajtje të pagës gjatë mandatit përgjatë të cilit janë zgjedhur. Në kontekstin e lartcekur, Gjykata thekson që nuk është kontestuese që Ligji i kontestuar, ka “ndërhyrë/kufizuar” të drejtat e funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve të shtetit të përcaktuara me ligjet e Republikës së Kosovës dhe të cilat shfuqizohen me hyrjen në fuqi të Ligjit të kontestuar. Pika **380**. Gjykata ka konstatuar se paragrafi 6 i nenit 6 (Paga bazë) dhe paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 (Shtesa tranzitore) të Ligjit të kontestuar janë në kundërshtim me Kushtetutën, përkatësisht me të drejtën në gëzimin paqësor të pronës dhe barazinë para ligjit. Kjo, sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, ndër të tjera, sepse (i) zbritja joproporcionale e nivelit të pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Kosovës është në kundërshtim të plotë me parimet kushtetuese, ligjore, parimet relevante ndërkombëtare dhe

praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese dhe përtej cenimit të të drejtave respektive individuale, rezulton edhe në cenim të ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe vlerave të Republikës së Kosovës; (ii) zbritja e nivelit të pagës dhe përjashtimi nga të drejtat e periudhës tranzitore të kategorisë së shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës është plotësisht joproporcionale dhe përtej cenimit të së drejtës në gëzim paqësor të pronës, cenon edhe parimin e barazisë para ligjit; (iii) mekanizmat e zgjedhur nga Qeveria dhe Kuvendi për zbritjen e nivelit të pagave të funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve që hyjnë në fushëveprimin e Ligjit të kontestuar, nuk janë proporcionale me qëllimin e ndjekur, dhe për pasojë në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në nenin 55 të Kushtetutës; (iv) përcaktimi i dallimit në mes funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve që janë punësuar para ose pas hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar, në kontekst të të drejtave të përcaktuara përmes periudhës tranzitore, afekton të drejtat për barazi para ligjit sepse nuk është proporcional me qëllimin e ndjekur; ndërsa (v) përgjysmimi i shtesës për përvojën e punës për të gjithë kategorinë e funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve për pesëmbëdhjetë (15) vitet e para të përvojës së punës, kufizon të drejtat dhe liritë themelore të tyre, pa asnjë qëllim legjitim në kundërshtim me përcaktimet e nenit 55 të Kushtetutës. 383. Ndërsa, në balancimin në mes të drejtave dhe lirive themelore dhe parimit të sigurisë juridike dhe parashikueshmërisë, Gjykata, përmes këtij Aktgjykimi do të shpallë të pavlefshme dhe do të shfuqizojë paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar. Shfuqizimi i paragrafëve që ndërlidhen me periudhën tranzitore, bazuar në paragrafin 1 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar, ka pasojën e (i) mbajtjes së nivelit ekzistues të pagave në sektorin publik, përkatësisht pamundësinë e zbritjes së pagave deri sa paga e re të bëhet e barasvlershme me pagën aktuale; (ii) kthimin e pagës të paktën në nivelin para hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar për kategorinë e shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës dhe të cilët nuk kanë përfitur nga shtesa tranzitore prej njëqind për qind (100%) përgjatë vitit 2023, për dallim nga të gjitha kategoritë tjera; dhe (iii) nivelizimin e pagave të funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve që janë punësuar pas hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar sipas përcaktimeve të pikës 1.4 të nenit 4 (Parimet e sistemit të pagave) të Ligjit të kontestuar.

Në fakt, Gjykata Kushtetuese përmes konstatimeve të dhëna në pjesën **IV. Efektet e Aktgjykimit**, ka sqaruar me pikën 376. Konstatimet e Gjykatës sipas sqarimeve të dhëna në këtë Aktgjykim, ndikojnë në efektet e këtij Ligji në dy mënyra. **E para** ndërlidhet me konstatimet e Gjykatës lidhur me sistemin e pagave dhe shpërblimeve dhe procedurave përkatëse për atë që afektojnë pavarësinë funksionale, organizative dhe buxhetore të institucioneve të pavarura kushtetuese; **ndërsa e dyta** ndërlidhet me konstatimet e Gjykatës lidhur me zbritjen e nivelit të pagës së funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve që hyjnë në fushëveprimin e Ligjit të kontestuar sipas përcaktimeve të Shtojcave të Ligjit të kontestuar, sipas sqarimeve në vijim:..”,

Për më tepër bazuar në sqarimet e dhëna përmes pjesës **IV. Efektet e Aktgjykimit**, me konkret nga pika 373 e deri tek pika 388, arrihet në përfundimin se paragrafi 2 i nenit 45 të Ligjit të Pagave në Sektorin Publik, është shpallur i pavlefshëm vetëm në raport me Institucionet e pavarura kushtetuese dhe Sistemit të drejtësisë, ndërsa paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 të Ligjit të Pagave në Sektorin Publik, shpallen të pavlefshëm në raport me të gjitha institucionet shtetërore. Në ndërlidhje me këtë të fundit, Kolegji rithekson përcaktimet si në pikën 385, të aktgjykimit ku shprehimisht thuhet: “385. Bazuar në pretendimet dhe argumentet e parashtruara para saj, Gjykata nuk ka trajtuar Shtojcat që janë pjesë përbërëse e nenit 44 të Ligjit të kontestuar. Përkundër faktit që (i) bazuar në vet Ligjin të kontestuar, ulja e pagës mund të bëhet vetëm si rezultat i një tronditje makroekonomike e cila rezulton në zvogëlimin e të ardhurave dhe/ose një fatkeqësie natyrore sipas kuptimit të nenit 131 të Kushtetutës, përkatësisht shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme në Republikën e Kosovës; dhe (ii) emëruesit të përbashkët të praktikës gjyqësore të Gjykatave tjera Kushtetuese, GJEDNJ-së dhe GJDBE-së, që ulja e pagës, në parim, mund të bëhet vetëm në rrethana të krizave ekonomike dhe/ose financiare, Gjykata ka vlerësuar qëllimin e Ligjit të kontestuar për të krijuar “një sistem të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik” si qëllim legjitim. Për pasojë, ajo nuk ka shpallur në kundërshtim me Kushtetutën nenin 44 të Ligjit të kontestuar përkitazi me Shtojcat në lidhje me

paragrafin 1 të nenit 45 të Ligjit të kontestuar që përfshinë shfuqizimin e një numri të dispozitave të ligjeve të veçanta dhe të cilat rregullojnë pagën e një numri institucionesh në Republikën e Kosovës. Sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, “një sistem të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik” arrihet përmes paragrafit 1 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar dhe sipas të cilit, nëse një zyrtar/e publik/e apo funksionar/e publik/e, para hyrjes në fuqi të këtij ligji përfitonte pagë që është më e madhe se paga e plotë e parashikuar me këtë ligj, ajo/ai do të përfitojë pagën e re sipas dispozitave të këtij ligji dhe shtesën tranzitore të barabartë me diferencën ndërmjet pagës aktuale dhe pagës së re bazë.

Nisur nga fakti së e drejta e pagës, përben një nga të drejtat me themelore nga marrëdhënia e punës, Gjykata Kushtetuese bazuar në praktiken e saj të mëhershme, serish më Aktgjykimin për rastin Nr.KO79/23, ka ritheksuar së e drejta në pagë të fituar është e drejtë e pronës dhe ka të gjitha atributet e kësaj të drejtë të garantuar më kushtetutë, rrjedhimisht si e drejtë e pa tjetërsueshme, duke sqaruar përmes pikës 383 të aktgjykimit se: *Ndërsa, në balancimin në mes të drejtave dhe lirive themelore dhe parimit të sigurisë juridike dhe parashikueshmërisë, Gjykata, përmes këtij Aktgjykimi do të shpallë të pavlefshme dhe do të shfuqizojë paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar. Shfuqizimi i paragrafëve që ndërlidhen me periudhën tranzitore, bazuar në paragrafin 1 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar, ka pasojën e (i) mbajtjes së nivelit ekzistues të pagave në sektorin publik, përkatësisht pamundësinë e zbritjes së pagave deri sa paga e re të 110 bëhet e barasvlershme me pagën aktuale; (ii) kthimin e pagës të paktën në nivelin para hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar për kategorinë e shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës dhe të cilët nuk kanë përfituar nga shtesa tranzitore prej njëqind përqind (100%) përgjatë vitit 2023, për dallim nga të gjitha kategoritë tjera; dhe (iii) nivelizimin e pagave të funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve që janë punësuar pas hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar sipas përcaktimeve të pikës 1.4 të nenit 4 (Parimet e sistemit të pagave) të Ligjit të kontestuar”.*

Rrjedhimisht, referuara përcaktimit si më lartë, dhe dukë qenë së Komuna e Prishtinës nuk hynë në institucionet e të pavarura kushtetuese, atëherë, rezulton së paragrafi 2 i nenit 45 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, nuk gjen zbatim në këtë çështje administrative, mirëpo, në rastin konkret vijnë në shprehje dispozitat e shtesës tranzitore sipas nenit 41 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, ashtu, siç është sqaruar më Aktgjykimin për rastin nr. KO79/23 të Gjykatës Kushtetuese, gjegjësisht më efekt juridik nga hyrja e tij në fuqi me 01 shkurt 2024.

Bazuar në konstatimet si me sipër, Kolegji ka gjetur së ankuesi para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik ka realizuar koeficient 15 të pagës, ndërsa, pas hyrjes në fuqi të ligjit realizon page me koeficient 6, që nënkupton së paga e ankuesit sipas Ligjit për Sektorin Publik është me ulët së paga qe ankuesi e ka realizuar para hyrjes në fuqi të ligjit, mirëpo, nga analizimi i provave të lëndës rrjedhë së ankuesi realizon pagë të njëjtë përmes aplikimit të shtesës tranzitore lidhur me diferencës e pagës. Gjegjësisht, sipas shkresave të lëndës rrjedhë së ankues para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196, ka realizuar pagë bruto prej 1.015.50 euro, ndërsa, pas hyrjes në fuqi të ligjit është duke realizuar pagë sipas koeficientit 15-6, si dhe shtesën tranzitore prej 317.55 euro, pra vazhdon të realizoj pagë të njëjtë bruto prej 1015.50 euro, kështu që mbi këtë konstatim, rrjedhë së nuk ka mbështetje pretendimi ankimor lidhur me koeficientin, sepse, siç edhe u tha me sipër në çdo rast ku zyrtari publik ka realizuar paga e cila është me madhe se sa paga qe i njihet sipas ligjit te ri për pagat, atëherë zyrtari ruan pagën e njëjta përmes aplikimit të shtesës tranzitore.

Lidhur me pretendimin e ankueses referuar kompensimit lidhur më përvojën e punës, Kolegji i Këshillit iu referua nenit 6 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, me të cilin është përcaktuar se: *“6. Paga bazë rritet në bazë të përvojës së punës, në masën: 6.1. zero pikë njëzetë e pesë për qind (0.25%) për çdo vit të plotë pune, deri në pesëmbëdhjetë vite (15) punë; dhe 6.2. zero pikë pesë për qind (0.5%) për çdo vit të plotë pune, mbi pesëmbëdhjetë vite (15) punë”*, dispozita këto të cilat i janë nënshtruar vlerësimit të kushtetutshmërisë nga ana e Gjykatës

Kushtetuese, më c 'rast, kjo e fundit me Aktgjykimin për rastin nr. KO79/23, në pikën II të dispozitivit ka konstatuar se paragrafi 6 i nenit 6 (Paga bazë) të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është në përputhshmëri me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 [Mbrojta e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ndërsa, në pjesën arsyetues gjegjësisht në pikët 380 dhe 381 ka sqaruar: 380. *Gjykata ka konstatuar se paragrafi 6 i nenit 6 (Paga bazë) dhe paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 (Shtesa tranzitore) të Ligjit të kontestuar janë në kundërshtim me Kushtetutën, përkatësisht me të drejtën në gëzimin paqësor të pronës dhe barazinë para ligjit. Kjo, sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, ndër të tjera, sepse (i) zbritja joproporcionale e nivelit të pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Kosovës është në kundërshtim të plotë me parimet kushtetuese, ligjore, parimet relevante ndërkombëtare dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese dhe përtej cenimit të të drejtave respektive individuale, rezulton edhe në cenim të ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe vlerave të Republikës së Kosovës;....ndërsa (v) përgjysmimi i shtesës për përvojën e punës për të gjithë kategorinë e funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve për pesëmbëdhjetë (15) vitet e para të përvojës së punës, kufizon të drejtat dhe liritë themelore të tyre, pa asnjë qëllim legjitim në kundërshtim me përcaktimet e nenit 55 të Kushtetutës. 381. Thënë këtë, sipas sqarimeve të dhëna më sipër ndërlidhur dhe me efektin e Aktgjykimeve të Gjykatës, kjo e fundit (i) nuk do të shfuqizojë paragrafin 6 të nenit 6 (Paga bazë) të Ligjit të kontestuar, ndërsa (ii) do të shfuqizojë paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar.*

382 Kjo sepse, lidhur me paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar që ndërlidhet me shtesën mbi pagën për përvojën e punës, Ligji i kontestuar në paragrafin 1 të nenit 45 të tij, ka shfuqizuar edhe Ligjin nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, i cili përfshin nenin 18 (Shtesa mbi pagën për përvojën e punës) sipas të cilit, për çdo vit të përvojës së punës të kaluar në shërbimin civil dhe jashtë tij, përveç përvojës së kaluar në punë praktike, nëpunësit civil sipas këtij ligji i takon e drejta shtesë në pagën bazë prej zero pikë pesë përqind (0,5%). Shpallja e pavlefshme e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar i kombinuar me faktin që Ligji nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë shfuqizohet gjithashtu përmes paragrafit 1 të nenit 45 të Ligjit të kontestuar, do të rezultonte në zbrazëti ligjore, përkitazi më të drejtën për shtesa mbi pagën për përvojën e punës. Për pasojë, duke balancuar parimin e sigurisë juridike dhe të drejtat dhe liritë themelore, Gjykata do të lë në fuqi paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar në periudhën prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi, duke i përcaktuar detyrimin Kuvendit, që brenda kësaj periudhe të ndryshojë dhe/ose plotësojë paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar në pajtim me konstatimet e këtij Aktgjykimi. Në ndryshimin dhe/ose plotësimin e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar, Kuvendi duhet të ketë parasysh që efektet e ndryshimit/plotësimit të tij në kontekst të lartësisë së shtesës për përvojën e punës burojnë që nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi.”,

Andaj, duke qenë se Kuvendi i Kosovës brenda afatit të përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese nuk ka bërë plotësim/ndryshimin e nenit 6, paragrafi 6 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Këshilli në mungesë të këtij rregullimi ligjor, nuk ka juridiksion që të detyroj institucionet publike të bëjnë kompensimin e përvojës së punës për zyrtarët publikë sipas sqarimeve të Gjykatës Kushtetuese, dhe rrjedhimisht mbi këtë bazë Këshill nuk mund të trajtoj ligjshmërinë e pretendimit ankimor lidhur me kompensimin për përvojën e punës, kështu që, pretendimi ankimor mbi këtë bazë, nuk ka mbështetjeje ligjore.

Theksuar si më sipër, Kolegji bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.54/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, A.M;
- Organit të Punësimit: Kryetarit dhe
Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.